



**Roli i Policimit ne Komunitet si
parandalues i krimit dhe ngjarjeve
me natyrë kriminale; Orientimi i
raportit Viktimë-Autor-Polici;
Detë-Mbrojtja dhe limitet e saj;
Teknikat e Verbal Judo.**



*Qyteti:
Elbasan*

*Vendi i zhvillimit:
Shkolla e Bashkuar
'Luigj Gurakuqi'*



**Roli i Policimit ne Komunitet si
parandalues i krimit dhe ngjarjeve
me natyrë kriminale; Orientimi i
raportit Viktimë-Autor-Polici;
Detë-Mbrojtja dhe limitet e saj;
Teknikat e Verbal Judo.**



SWEDEN



SACP Programme



GHANDI JUDO KLUB

*Qyteti:
Elbasan*

*Vendi i zhvillimit:
Shkolla e Bashkuar
'Luigj Gurakuqi'*

**Roli i Policimit ne Komunitet si
parandalues i krimit dhe ngjarjeve
me natyrë kriminale; Orientimi i
raportit Diktimë-Autor-Polici;
Detë-Mbrojtja dhe limitet e saj;
Teknikat e Verbal Judo.**



Qyteti :Elbasan

Vendi i zhvillimit :Shkolla e Bashkuar 'Luigj Gurakuqi'

KAPITULLI 1

Përse policimi në komunitet është i rëndësishëm për popullsinë dhe në veçanti për të rinjtë?

Duke qenë një model i ndryshimit organizativ dhe institucional i pranuar në shumicën e vendeve Europiane që kontribuon në përmirësimin e dukshëm të shërbimeve të kryera nga Ministria e Brendshme, Policimi në Komunitet përfaqëson një koncept dhe një medoel modernizimi që ka si objektiv përqasjen e policisë në nevojat e komunitetit.

Respekti i personalitetit njerëzjor dhe demnitetit të personit, mbrojtja e të drejtës për tu shprehur lirshëm, mbrojtja e pronës private dhe lirisë, aplikimi strikt i ligjit në të gjitha fushat, pa ndëshkuar pa motiv, bashkëpunimi me komunitetin, janë panteoni ideal për misionin e brishtë dhe sensitiv të policimit në komunitet.

Demokracia nuk bazohet vetëm mbi barazinë dhe lirinë, por, edhe në bashkëpunimin e harmonizuar ndërmjet njerëzve për të mirën e përbashkët.

Liri nuk do të thotë vetëm imunitet por, edhe auto-disiplinë, respekt për vlerat dhe të drejtat e të tjerëve para ligjit dhe në përgjithësi.

Për të siguruar një shërbim sa më efikas të policimit në komunitet është i nevojshëm bashkëpunimi i qytetarëve, e cila vjen edhe si rrjedhojë e natyrës reciproke të ndër-veprimit polici popullatë. Kjo gjë është e njohur që nga koha e Sir Robert Peel, që ka thënë se “policia është popullata ndërsa popullata është policia”.

Një premisë tjetër që konfirmon rëndësinë e shërbimit të policimit në komunitet është ajo që del nga karakteristikat kyçe të këtij shërbimi dhe konkretisht:

- të jesh i dukshëm dhe i arritshëm për këdo;
- të mbartë përgjegjësi për aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e tyre;
- t'i përgjigjet nevojave të komunitetit;
- të jetë i afrueshëm me hallet e komunitetit;
- të implikojë dhe mobilizojë komunitetin;
- të njohë publikun dhe të njihet nga publiku.

Si rrjedhojë, parimet që janë shprehur më poshtë mund të konsiderohen fundmentale për Policimin në komunitet.

- a) zhvillimi i aktivitetit policor nëpërmjet bindjes dhe jo shtrëngimit;
- b) policia është pjesë integrale e komunitetit;
- c) caktimi i nevojave komunitare në dakordësi me njerëzit;

- d) aktivitet i bazuar në partneritet me autoritetet e tjera dhe publikun;
- e) transformimi dhe adaptimi i aktiviteteve të saj në lidhje me nevojat e komunitetit;
- f) mbajtja e përgjegjësisë për veprimet e saj para komunitetit;
- g) ofrimi i shërbimeve cilësore.

Parimet e mësipërme mund të ri-formulohen në një set karakteristikash të bazës për policinë në kuadrin e policimit në komunitet sigurimi i rregullit publik në mënyrë demokratike.

Policia duhet të jetë:

- Një shërbim, jo një forcë
- Një shërbim efficient dhe efektiv
- I përgjegjshëm para ligjit dhe publikut
- E hapur, e dukshme dhe lehtësisht e apelueshme
- Profesioniste
- E përqendruar tek personi, sensitive në raport me gjininë, moshën ose grupin në të cilin bën pjesë
- Konsultative dhe pjesëmarrëse
- Aktive dhe parandaluese

Kapitulli 2

Si e konsultojmë komunitetin tonë?

Duke njohur në mënyrë autentike komunitetin përkatës, për të lidhur realizimin e konsultimit me këtë komunitet, duhet të nisemi nga përkufizimi i një komuniteti të fuqishëm e cila përveç idesë së hapësirës (lagja, mëhalla) së delimituar gjeografikisht, vendos theksin mbi marrëdhëniet dhe ndërveprimet që caktohen ndërmjet personave dhe institutive që janë prezentë në territorin përkatës.

Theksi bie mbi:

- Marrëdhënie besimi dhe ndihme reciproke ndërmjet anëtarëve të komunitetit
- Solidaritet dhe aspirate të përbashkëta që vijnë nga nevoja dhe interesa të ngjashme
- Konsens mbi vlerat e anëtarëve të komunitetit
- Veprime të përgjegjshme për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta
- Interes dhe implikim për rritjen e cilësisë së jetesës për të gjithë banorët
- Orientim drejt zhvillimit dhe vetë-përmbajtjes
- Shpirt komunitar i fuqishëm i manifestuar

KAPITULLI 3

Si duhet të jetë sjellja e funksionarëve të policisë në marrëdhëniet me shoqërinë:

Për ruajtjen e zhvillimin e një imazhi pozitiv funksionari i policisë duhet të adoptojë një veshje dhe aspekt fizik të kujdesur, të manifestojë cdo ditë një sjellje të pacenueshme, të evitojë fjalët e tepërta, familjarizmat dhe gjestet e panevojshme, të demonstrojë sjellje dhe propozime të moderuara.

Gjestet e panevojshme, konkluzionet e pabazuara, mbi informacione të paverifikuara si edhe zgjidhjet arbitrare e thyejnë autoritetin dhe prestigjin e policisë dhe të degëve të saj.

Polici në veshjen e tij të shërbimit ose civil, përfaqëson simbolin e ligjit dhe të rregullit të drejtësisë dhe e gjithë shoqëria pret nga ai që të jetë i pari në respektimin e normave ligjore dhe të mos abuzojë me atributet e pozicionit të tij.

Për të fituar besimin e publikut dhe tërheqjen e tij në bashkëpunim, funksionari i policisë duhet të respektojë rregullat e mëposhtëm:

A. në lidhje me viktimën:

- të manifestojë trajtime pa diskriminim;
- të eliminojë frazat familjare;
- të jape prova për edukatë dhe vete-përmbajtje dhe të ruhet nga cdo lloj ngacimi, kundërshtimi provokues dhe cdo lloj situatë që mund të rrisë gjendjen e nervozitetit të viktimës.
 - të ndërhyjë në kohën më të shkurtër në vendin e ngjarjes.
 - të japë kohën e duhur për shpjegime për situatën e përballur.
 - të vërë në dispozicion mjete për të zgjidhur situatën shpejt.
 - të sigurojë mbrojtjen individuale dhe të mirave materiale të viktimës sa i takon nga ligji dhe situata.
 - të orinetojë viktimën drejt shërbimeve sociale që mund të japin asistencë e sipas nevojës të njëfotë këto shërbime për situatën e prodhuar.

B. në lidhje me dëshmitarin:

- të jetë me edukatë duke siguruar kushtet e pritjes;
- të marri parasysh gjendjen e tij psikike emotivitetin, frikën, etj.
- të manifestojë interes për deklaratat e tij .
- të respektojë rigorozisht rregullat e ruajtjes së sekretit profesional dhe të konfidencialitetit.
- Të evitohet cdo gjykim arbitrar sidomos për motivin e origjinës, të kushteve sociale, precedentëve gjyqësorë ose orientimit seksual.
- Të riprodhohet me korrektësi deklaratat e dëshmitarëve
- Të këshillojë mbi kontradiktat ose të pavërtetat e dëshmimeve.

C. në lidhje me personin e dyshuar për faktin jo-ligjor:

- Të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë
- Të respektojë strikt normat proceduriale
- Të jetë i paanshëm; të mbledhë prova si për akuzën ashtu edhe për mbrojtjen e personit të dyshuar qëllimi i hetimit
- Të manifestojë profesionalizëm dhe integritet moral
- Të respektojë rigorozisht sekretin profesional
- Të mos pranojë në asnjë rast sjellje, propozim apo veprim diskriminues, racist apo fyes.
- Të mos pranojë familjarizma dhe fjalë popullore
- Të përdorë masa shtrënguese vetëm në rast nevojë dhe t'i ndalë së aplikuari menjëherë sapo ka arritur objektivin e aksionit të tij
- Të përdorë forcën në funksion të ligjit dhe në proporcion me rezistencën e ndeshur duke e ndaluar sapo ka arritur imobilizimin
- Të mos kryejë veprime neglizhente dhune, trajtime jo-njerëzore ose degraduese, etj.
- Të krijojë kushte për dhënien e ndihmës së shpejtë në raste urgjence mjekësore dhe të sigurojë kushte ndalimi duke patur parasysh ruajtjen e jetës njerëzore dhe demnitetit njerëzor.

KAPITULLI 4

Raporti Autor - Viktimë - Polici

Që të kuptojmë sa më mirë këtë pjesë duhet të kemi parasysh që një agresion verbal apo fizik qoftë, ka dy palë agresorin, ngacmuesin, autorin, dhe të agresuarin, të dëmtuarin, viktimën.

Në çdo rast kemi të bëjmë me një konflikt dhe për të menaxhuar situatën konfliktuale duhet të dijmë shumë mirë perceptimin e konfliktit dhe ndërhyrjen që mund të bëjë policia. Por, gjithnjë me ndihmën tonë. Këtë do ta shtjellojmë në këtë prezantim.

Identifikimi dhe aplikimi i kriterëve të ndryshme klasifikuese arrin të bëjë një renditje dhe përshkrim të konflikteve si më poshtë (të paktën ato që do marrim ne në shqyrtim):

1. konflikt ndërmjet gjeneratave sipas kriterit të moshës, p.sh. ndërmjet të moshuarve dhe të rinjve, ndërmjet prindërve dhe fëmijëve;
2. konflikt ndërmjet grupeve shoqërore, klasave, kategorive, mikro-grupeve sipas kriterëve sociale ose të interesave të grupit. P.sh. konflikti mësues nxënës.
3. konflikti mes gjinive sipas kriterit të veçorive gjinore (seksuale) të kategorive të ndryshme, femra meshkuj;
4. konflikti ndër-personal sipas kriterit kompleks që reflekton një mori kriteresh: moshë, gjinia, feja, aspekti fizik, psikik, i personalitetit, i zanatit dhe profesionit, i historisë së jetës, etj.
5. konflikti ndërmjet individit dhe grupit sipas kriterit të specifikave individuale dhe ato të grupimit.

Një nga konfliktet më të përhapura por edhe më të deformuarat është konflikti mes gjeneratave, ky konflikt është i paevitueshëm për shkak të evolucionit të shoqërisë njerëzore, kulturës dhe familjes.

Nëse distanca fizike mes prindërve dhe fëmijëve ulët - se të rinjtë arrijnë të bëjnë fëmijë sa më herët distanca kulturore mes brezave rritet si pasojë e progresit të shpejtë dhe atij teknik në veçanti.

Si rrjedhojë, konfliktet mes brezave janë arsyetimisht gjithnjë e më të forta. Kjo nuk do të thotë që ato prodhohen automatikisht ose që janë identike, pavarësisht se kanë disa aspekte të përbashkëta të tipit: 'eh, në kohën time...' kjo është një nga paragjykimet që haset shpesh në këto lloj konfliktesh.

Konfliktet e këtij lloji degjenerojnë duke marrë me vete palët dhe autori mund të

bëhet agresiv duke dëmtuar në menyrë të dukshme viktimën. Ky lloj konflikti mund të lindë në banesën tuaj, të shokëve apo shoqeve tuaj dhe në lagjen tuaj. Pavarësisht se mund të ndodheni në moment të shtangur apo në udhëkryq se çfarë duhet të bëni, mos hezitoni por, lajmëroni policinë.

Duhet të dini një gjë; ju nuk e dini se kush ka të drejtë; ndoshta ka autori, ndoshta viktima por, nuk ju përket ju ta gjykoni konfliktin. Efektivat e policisë duhet të jenë të përgatitur për të ndërhyrë dhe ta drejtojnë konfliktin në rrugë zgjidhje, me një menaxhim efikas të konfliktit, nëpërmjet një procesi të këshillimit edukativ dhe të ndarjes së palëve. Hetimi i mëtejshëm i konfliktit do të sjellë edhe rezultatet që do të shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare por, ndërhyrja juaj duke lajmëruar policinë, bëri që konflikti të shuhet.

Konflikti mes mësuesve dhe nxënësve është një konflikt i tipit 'statuti kundër rolit' dhe dinamika e të cilit mund të çojë në zhvillimin e parteneriatit, bashkëpunimit mes dy kampeve ose në bllokimin e komunikimit.

Juve ose nxënës të tjerë të lagjes tuaj mund të kenë qenë dëshmitarë të konflikteve mes mësuesve dhe nxënësve dhe këto kanë forma dhe manifestime të ndryshme.

Në nivelin e klasës ku mësoni dhe të disiplinës që ju mësohet, konflikti ka keto qasje:

- Sasiore: sasia e informacioneve që ju mësohen;
- Cilësore: cilësia e këtyre informacioneve;
- E vlerësimit: rigoziteti, rreptësia, dashamirësia;
- E ndikuar nga marrëdhënia: sjellje deviante, mungesë totale interesi;

Në nivelin e shkollës konflikti mësues nxënës mund të jetë më tepër i natyrës edukative i lidhur me: objektivat, përmbajtjet, strategjitë edukuese dhe formuese, vështirësi asimilimi dhe realizime nga nxënësit.

Jemi të mendimit se këto konflikte kanë potencial të pafund problemesh por, edhe po kaq të pafund zgjidhjesh.

Konflikti mes gjinive dhe ai mes individit dhe grupit e anasjelltas është i karakterizuar nga fenomeni i ashtuquajtur në gjuhën e psikologjisë dhe atyre që studjojnë sjelljet deviante si "bullying".

Dan Olweus e përkufizon fenomenin e ngacmimit mes gjinive dhe individëve e grupeve si:

- Sjellje agresive ose veprim për të bërë keq me dashje;
- Një sjellje e cila përsëritet në kohë;
- Marrëdhëniet ndër-personale karakterizohen nga një ç'ekuilibër i fuqive.

Më tepër ky lloj konflikti mund të vijë edhe si pasojë e një mungese provokimi, kot fare, dhe veprimet negative mund të jenë të tipit verbal, sharje, fyerje, gjeste të

pahijshme, kontakt fizik dhe/ose përjashtim nga një grup i caktuar shokësh apo shoqesh.

Si të arrish të shmangesh nga këto lloj ngacmimesh ? Kur ato bëhen violente, të dhunshme a duhet të lëjmëroj policinë ? Po aktorët e tjerë, mësuesit, drejtorin e shkollës, prindërit?

Detyra e parë është të shmangesh, ti mund të bësh sikur nuk i dëgjon pavarësisht se brenda teje zjen. Ka shumë metoda për të lehtësuar veten nga këto situata dhe fenomene të përditshme. Kanë qenë prezente dhe do të jenë në shoqërinë tonë gjithnjë.

Kush është roli i policisë në rast se vihet në lëvizje ? Konsiderojmë se etapat për identifikimin dhe zgjidhjen e një konflikti të tillë por, edhe të rasteve të tjerë janë si vijon:

1. njohja e tipit të konfliktit në të cilin përfshihesh;
2. ndërgjegjësimi për kauzat por edhe të pasojave të konfliktit;
3. përballja me konfliktin dhe jo evitimi i tij; verbal judo
4. respekt për veten në raport me respektin e tjetrit;
5. evitimi i egos së tepruar dhe pranimi i të qëniet ndryshe;
6. diferencimi i qartë i interesave dhe pozicioneve;
7. identifikimi i interesave të përbashkëta dhe të krahasueshme;
8. bashkëpunimi;
9. dëgjimi me vëmendje, empatia;
10. përqendrimi i vëmendjes dhe jo hallaktja me gjera të tjera, sms e whassup...
11. njohja e situatave të ndryshme konfliktuale
12. zhvillimi i aftësive për të aborduar konflikte të vështira;
13. sjellje dhe qëndrim shumë moral për gjatë kohës së konfliktit.

KAPITULLI 5

Verbal Judo



Tani do ju prezantojmë një gjë shumë interesante. Kjo ka lidhje me mënyrën sesi një individ, qytetar apo polic qoftë, duhet të reagojë ndaj një konflikti verbal, ndaj një ngacmimi të momentit, ndaj një fenomeni të 'bullying' që e kemi përmendur herën e kaluar.

Ju kujtohet çfarë është 'bullying' dhe si ishin karakteristikat e tij? E kemi përmendur tek konflikti mes gjinive dhe individëve dhe grupeve. Për të bërë keq me dashje, e përsëritur dhe me ndryshim dhe pabarazi të fuqive. Këto janë tre tiparet dalluese të 'bullying' sipas përkufizimit.

Atëherë çfarë ndodh kur gjendeni përpara një personi agresiv dhe që ju ngacmon verbalisht? Si reagoni?

Normalisht që nuk ndjeheni mirë, mund edhe të nxehemi, mund të skuqemi, ta ndjejmë veten të turpëruar pasi nuk duam të jemi të ngacmuar, të na shajnë apo tallin, të na vënë në lojë apo të na japin urdhëra kot më kot.

Realisht ka dy mënyra, e para të përfshihesh në ngacmim e kjo mund të çojë në konflikt dhe e dyta ta shmangësh atë e t'i largohesh konfliktit.


Tani do ju tregoj një gjë tjetër dhe do kthehemi përsëri te kjo që thamë më para. Ju po rrini mbi ca dyshekë... e dini si quhen këto? Quhen Tatami. Është një fjalë japoneze dhe këto janë dyshekë që përdoren në sportin e xhudos. (Judo)



柔道

JU dhe DO.

Janë dy fjalë në japonisht që përkthehen "mënyra delikate" (the gentle way). Në sport kjo ka një domethënie; në një ndeshje ai që mundet të fitojë është ai që përdor më mirë energjinë e kundërshtarit. Që e kupton fluksin e energjisë, arrin të dallojë ngarkesën negative dhe mundohet ta shmangë atë për të mos u bërë pjesë e dinamikës së kundërshtarit. Dhe kjo arrihet në mënyrë delikate.



Edhe në komunikimin mes nesh është e njëjta gjë. Ne kur flasim themi atë që mendojmë dhe në disa raste atë që është e mirë për ne. Por, një shprehje indiane thotë: 'ajo që është e mirë për ne, mund të mos jetë e mirë' ... përdorimi i shprehjeve ngacmuese sidomos ndaj vajzave i bën djemtë të ndihen më mirë, më të fortë, sikur kontrollojnë komunikimin dhe kjo mund të japë rezultatin e duhur. Pastaj bëhen edhe për shaka... por, nganjëherë mund të jenë pak fyese.



P.sh. i themi një vajze... '**moj boluce!**'... '**si dëng leshi më je!**' Si mund të përgjigjet vajza?

'ore më vjen mirë që e ke vënë re që jam dobësuar një çik' dhe me buzën në gaz, vajza mund të largohet e qetë.

Ose mund t'i thuhet një djali... '**o qorr!**' vetëm se mban syze p.sh. si mund të përgjigjet ai?

'po jo mi, janë për modë, m'i dha njëra nga Facebook-u' dhe duke shkelur syrin djali mund të largohet dhe të shohë punën e tij.

Pra, ne përdorim një 'mënyrë delikate' në komunikimin i cili mund të na sjelli konflikt; shmangim konfliktin, dhe e drejtojmë bisedën në një vëmendje tjetër. Kjo kategorizohet si 'verbal judo' sepse njësoj si sporti le hapësirë për të përdorur energjinë që ka tjetri pikërisht kundër tij, dhe jo të thithesh nga dinamika e kundërshtarit e cila mund të çojë edhe në konflikt fizik.

Arsyet që të shtyjnë të përdorësh teknikën e shmangies janë:

- të bën të ndihesh mirë;
- e fokuson ngacmimin jashtë teje;
- e shfuqizon kundërshtarin;

Mënyra se si flasim na përkufizon. Verbal judo është një mënyrë sjelljeje e cila ashtu si vetë sporti ka brenda delikatesën në komunikimin për të shmangur konfliktin apo ngacmimin dhe për t'i lejuar vetes të mos përfshihesh në situata të rrezikshme.

Fenomeni i ngacmimit (bullying) është një shfaqje gjuetie. Personi ose grupi agresor gjen dikë më të dobët se vetja për ta ngacmuar dhe kjo është një lloj gjuetie, e kërkon këtë individ, e ndan nga pjesa tjetër e shoqërisë ose grupimit dhe e sulmon. Në sportin e judos ne i mësojmë nxënësit tanë të mos e tregojnë veten të dobët, të forcojnë respektin për veten por, dhe për të tjerët dhe jenë sa më modestë, sa më të


thjeshtë në komunikim e të mos gënjejnë e të mos tregohen të nxituar duke u hedhur në situata që nuk janë për ta.

Sporti i judos të lejon të mposhtësh frikën, gjithnjë ke kundërshtarë në tatami dhe duhet të ndeshesh me ta për të arritur fitoret e të kapësh vendet e para; për këtë duhet shumë punë, shume sakrifica dhe përsëritje të teknikave.

Meqë ky projekt ka të bëjë me afrimin e popullatës tek policia, ndryshimin e konceptit për policinë, njerëzit dhe punën e saj, na duhet të themi se kjo teknikë është një metodë efikase e cila pasuron personelin e ruajtjes së rendit publik me aftësi të Komunikimit Taktik. Forcave të rendit iu duhet të përballen me shumë probleme dhe shumë tipe njerëzish gjatë punës së tyre dhe masa e stresit dhe ngarkesa psikologjike mund të shkaktojnë që t'i dalë situata nga duart. Duke ditur si “të ridrejtosh, (kanalizosh) sjelljen e njerëzve duke përdorur fjalët” është arma më e fortë që ka në dispozicion një oficer policie.

Ekzistojnë 5 të vërteta të pathyeshme dhe universale; këto na mësojnë se sa njerëzit janë njësoj me njëri tjetrin dhe sa pak të ndryshëm jemi.

1. të gjithë njerëzit duan të trajtohen me dinjitet dhe respekt;
2. të gjithë njerëzit duan t'i pyesësh më mirë se sa t'i urdhërosh të bëjnë dicka;
3. të gjithë njerëzit duan t'i thuhet pse i kërkohet të bëjnë dicka;
4. të gjithë njerëzit duan që t'i jepen mundësira (opsione) në vend të kërcënimeve;
5. të gjithë njerëzit duan një shans të dytë;



teknika te vete-mbrojtjes – sulmi nga prapa dhe krahe-supi



teknika te vete-mbrojtjes – 'perqafimi i ariut' dhe terheqja e kembes



teknika te vete-mbrojtjes – koshi-guruma ose oki-goshi



teknika te vete-mbrojtjes – shpetimi nga mbytyja nga prapa

KAPITULLI 7

Dita ndërkombëtare kundër dhunës në shkollë, 30 Janar 1964.

Rëndësia dhe arsyeja

Personat e angazhuar në shkolla dhe policia në komunitetin tuaj.

Dialog me nxënësit

- Armët e bardha dhe armët e zjarrit
- Ndëshkimi për mbajtjen e tyre.

Padyshim, dhuna njerëzore është një fenomen kompleks, e cila ka anën psikologjike, sociale, kulturore dhe ekonomike.

Kjo gjë është shumë evidente nëse marrim në konsideratë gjërësinë e formave të saj dhe llojet e manifestimeve dhe marrëdhëniet që ndërtohen.

Përveç diversitetit të fenomenit të dhunën njerëzore, përpjekjet për ta konturuar dhe perifrashuar në nivel global dhe kombëtar, kanë nevojë për një njohje të saj, kategorizimin conceptual, tematik dhe operacional për të patur një abordim sa më integral.

Dhuna në shkollë është një nga manifestimet e dhunës së përditshme.

Diskutimet që kanë të bëjnë me konceptin e “të drejtës për siguri” dhe ambientit shkollor kanë marrë një zhvillim të madh në Europë duke u bërë një problem që ka kërkuar zgjidhje edhe politike për përcaktimin e disa normave dhe rregullave dinamike për të shmangur dhunën në shkolla.


Që nga fillimi i viteve 1950 e në vazhdim, UNESCO ka filluar një seri veprimesh për të promovuar edukimin e bazuar në parimet e paqësisë, jo-dhunës dhe tolerancës.

Kultura e paqes e promovuar nga kjo organizatë sot, ka vendin e saj historik në vijimësi të fondacionit që lindi në vitin 1945.

Në Deklaratën dhe Programin e Aksionit për një Kulturë të Paqes UNESCO bën thirrje që fëmijët të marrin një edukim në vlera, sjellje dhe mënyra jetese që i lejojnë ata të zgjidhin konfliktet në mënyrë paqësore dhe në frymën e respektit për dinjitetin



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization



human, tolerancën dhe mos-diskriminimin.

Së afërmi, Këshilli i Evropës ftoi të rinjtë nga i gjithë kontinenti të realizojnë një projekt për shkollat demokratike pa dhunë, mbi bazën e vlerave dhe parimeve fundamentale që ndahen nga të gjithë Europianët dhe që pasqyrohen qartë në Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

- Të gjithë anëtarët e një komuniteti shkollor kanë të drejtën e sigurisë dhe të një ambjenti të sigurtë. Të gjithë kanë përgjegjësi të kontribuojnë për të krijuar një mjedis pozitiv dhe inspirues për mësim dhe zhvillim personal.

- Secili ka të drejtë të trajtohet baraz me të tjerët dhe me respekt pavarësisht diferencave personale. Secili gëzon të drejtën e fjalës pa rrezikuar diskriminim ose dhunë.

- Komuniteti shkollor duhet të sigurojë se cdokush është i përgjegjshëm për të drejtat dhe detyrimet që ka.

- Cdo shkollë demokratike ka një autoritet të zgjedhur të përbërë nga nxënës, mësues, prindër, dhe anëtarë të tjerë të komunitetit shkollor. Të gjithë kanë të drejtën e votës.

- Në një shkollë, konfliktet duhet të zgjidhen në një mënyrë jo violente dhe konstruktive në bashkëpunim dhe mirëkuptim.

- Cdo rast dhune duhet të hetohet dhe të shikohet seriozisht nëse një nxënës apo një anëtar tjetër i komunitetit shkollor është i përfshirë.

- Shkolla është një pjesë e komunitetit lokal. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me policinë, prindërit, komshinjtë, dhe të tjerë është i rëndësishëm për para-ndalimin dhe zgjidhjen e problemeve.

Mund të jetë fare e rastësishme që data e 30 janar 1964 është caktuar si Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës në Shkollë; në Hemisferën e Jugut kjo vërehet nga periudha e 30 Marsit.

Në vitin 1964, sporti i Judos është pranuar si sport olimpik në Olimpiadën e Tokios. Kurse po në këtë datë në vitin 1948 ka vdekur Mahatma Gandhi. (një njeri që udhëhoqi Indinë drejt pavarësisë nga britanikët pa dhunë)

Dita Kundër Dhunës në Shkollë dhe e Paqes është si një farë që mbillet dhe kultivohet në zemrat e nxënësve; është një mënyrë pozitive, e re dhe e ndricuar për të parë botën dhe për t'u përgatitur për të ardhmen.

'Jeta e njëzëmi dhe, ndoshta, progresi ose shuarja e civilizimit, varet nga paqja'
Maria Montessori.

" Mësojini fëmijët tuaj të rriten në vllazëri dhe paqe dhe mbajini larg nga rrugët e errëta të urrejtjes dhe dhunës. " Libri i Vogël i Vetmitarit.

Kjo ditë vjen me filozofinë e praktikën e eliminimit të dhunës (që kuptohet si një hap përpara vrasjeve, dhe dhunimit të qenieve njerëzore nga mendimet, fjalët dhe veprimet) në idenë e paqes pozitive, në konceptin e dashjes së tjetrit dhe jo urrejtjes dhe në edukimin pedagogjik të tre objektivave bazë : rritjen e vëmendjes , ushtrimin e nxënësve për të ndërjerë përgjegjësinë e tyre dhe procedura të tjera mësimore

Në projektin tonë ndihmohemi edhe nga prezenca dhe këshillat e uniformave blu. E kemi përmendur në leksionet e fillimit që 'policia është popullata dhe popullata është policia' ; jo më kot kjo shprehje gjen kuptim. Njëri nga fëmijët këtu mund të

ketë të afërm që janë në polici, jo vetëm kaq por, të gjithë ne kemi ndërveprim me policinë, në rrugë, në lagje, në ambiente të tjera.

Ata gjithnjë janë në rolin e parandaluesve të ngjarjeve të dhunshme, të konflikteve dhe ngjarjeve të tjera por, në këtë pozicion ata kanë këshilla shumë të vlefshme për ju fëmijë dhe mësues e prindër.

Fëmijët janë të ndryshëm; ju jeni të ndryshëm nga shokët tuaj;

Ndihmoni shokët, të cilët kanë nevojë për ndihmën tuaj për shkak se ai/ajo flet gjuhë tjetër nga ajo e jotja;

Nëse një shok/shoqe kërkon ndihmën tuaj, kontaktoni mësuesin ose drejtorin e shkollës dhe ndihmoni shokun/shoqen tuaj;

Nëse e shihni që shoku/shoqja juaj është goditur fizikisht nga të tjerët, thirrni menjëherë mësuesin ose drejtorin e shkollës. Nëse jeni jashtë hapësirës së shkollës ose shtëpisë, telefononi në numrin 129. polica.

Prindër dhe mësues, secili fëmijë duhet ta gëzojë të drejtën që të rritet dhe zhvillohet në mjedis të sigurt dhe të qetë. Fëmijët dallojnë nga njëri tjetri në bazë të gjuhës që flasin, pamjes fizike, gjinisë, racës, aftësive dhe shkathtësive, fesë, përkatësisë kombëtare. Kjo larmi vetëm se e pasuron dhe plotëson komunitetin si tërësi.

Prindër dhe mësues, flisni me fëmijët tuaj për larminë në shoqëri dhe inkurajoni ata që të jenë pjesë e kësaj larmie. Të gjithë së bashku mund të bëjmë ndryshime pozitive në shoqëri.

Prindër, mesues dhe fëmijë, ka shumë gjëra të panjohura në lidhje me sigurinë në internet dhe përdorimin e tij. Fëmijët, të cilët e përdorin internetin për qëllime arsimore dhe argëtuese kërkojnë të marrin parasysh kurthet e mundshme që janë brengosëse kur flasim për sigurinë dhe mirëqenien e tyre

Mos jepni informata personale në internet;

Mos dërgoni fotografi ose video tuaja- as mos pranoni të tilla nga të tjerët;

Mos i hapni mesazhet e dërguara me postë elektronike nga adresat e panjohura;

Keni kujdes kur të komunikoni. Komunikoni vetëm me njerëz që i njihni

Raportoni mesazhet te prindërit dhe policisë.

Fëmijë,

• Tregoni prindërve se jeni duke shkuar, me kë jeni duke shkuar dhe kur pritët të ktheheni;

• Qëndroni bashkë me grupin tuaj;

• Shmanguni nga takimi me të panjohur në zona të panjohura dhe të izoluara;

• Silluni dhe luani vetëm në vendet që i njihni prej më parë;

• Mos ndizni zjarre;

• Nëse vëreni ndonjë zjarr informoni prindin ose mësuesin tuaj;

• Mos leni mbeturina prapa vetes, hidhni ato në vendet e mbeturinave.

Kontribuoni për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm! Mbeturinat mund t'i tërheqin kafshët dhe në këtë mënyrë ta rrezikoni sigurinë tuaj.

Policia në komunitetin tuaj është e përkushtuar që nëpërmjet projekteve të tilla t'iu ndihmojë fëmijëve dhe të rriturve në përmirësimin e sigurisë në shkolla, shtëpi dhe vende të tjera.

**Roli i Policimit ne Komunitet
si parandalues i krimit dhe ngjarjeve
me natyrë kriminale;
Orientimi i raportit Viktimë-Autor-Polici;
Detë-Mbrojtja dhe limitet e saj;
Teknikat e Verbal Judo.**

